



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e IV-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2024.

Seanca mbahet më 26.04.2024 (e Premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë: 29.03.2024,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-mars 2024,
5. Interpelancë lidhur me punësimet në komunë dhe punësimet me kontrata mbi vepër (Ref. drejt. Administratës),
6. Interpelancë lidhur me numrin e lejeve apo pëlqimeve të lëshuara për operatorët gurthyes (Ref. DUMM),
7. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-1325.9 2024
Klinë, me 16.04 2024



Kryesuesi,
Fadil Gashi



Na osnovi člana 43, 45 i 47 Zakona 03/L-040 o Lokalnu Samoupravu, člana 47 Statuta Opštine Klina 01-110-1232/2010, člana 5 AU MLS broj 02-2015 o sastancima skupštine opštine i člana 4 pravilnika za rad skupštine i opštinskih komiteta, predsedavajući Skupštine Opštine vrši sledeće:

OBAVEŠTENJE

Pozivaju se članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da prisustvuju **IV-oj** sednici SO za 2024 godinu.

Sastanak se održava **26.04.2024 (Petak)**, u Sali Skupštine Opštine od 10:00.

U slučaju neprisustvavanja sastanku, molimo vas da se oslonite odredbi člana 39 ZLS.

Predloženi:

DNEVNI RED:

1. **Obrazloženje izostanaka,**
2. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa sednice održane 29.03.2024,**
3. **Razmatranje i usvajanje preporuka Političkog i Finansijskog Komiteta,**
4. **Razmatranje izveštaja o finansijskom upravljanju za period januar-mart 2024. godine,**
5. **Interpelacija o zapošljavanju u opštini i zapošljavanju preko ugovorima o radu (referise Uprava Administracije,**
6. **Pitanje u vezi sa brojem izdatih dozvola ili saglasnosti operaterima kamenoloma (Ref. UUZS),**
7. **Pitanja i odgovori.**

01Br. 06-13239 /2024
Klina 16.04 /2024



Predsedavajući,
Fadil Gashi



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. _____ 2024

Klinë,

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e punës së Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 29 Mars 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje është kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e Komunës, znj. Marqe Selmani, përfaqësuesi i policisë, drejtorë të drejtorive, media lokale dhe qytetarë. Kryesuesi konstatoi se janë 24 anëtarë prezent ndërsa Blerta Gashi nuk do të marr pjesë ndërsa Kushtrim Haliti dhe Ilir Hoti pritet të i bashkohen mbledhjes.

Në lidhje më rendin e ditës Kryesuesi tha se është një pikë shtesë , materiali ka ardhur pasi që është shpërndarë materiali për këtë mbledhje dhe bëhet fjalë për një vendim të marrur nga ky kuvend për kompensim të trupave dhe komiteteve që i ka formuar ky kuvend dhe që sipas ministrisë së linjës duhet të rishikuar.

Për rendin e ditës fjalën e morri zonja Valmira Krasniqi e cila propozoi që për seancën e sotme të futet në rend dite propozimi për subvencionimi për çerdhe private dhe lirimi nga pagesat në ato publike për nenat vetushqyese. Zonja Krasniqi e arsyetoi propozimin e saj duke folur për rëndësinë e kësaj iniciative.

Kryesuesi në vazhdim për këtë propozim tha se rendi i ditës përpilohet nga kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës dhe shpjegoi se kur kanë të drejt që të bëjnë pika shtesë në rendin e ditës duke thënë se kjo bëhet vetëm në rast urgjence . Propozimin e znj, Valmira Krasniqi e vuri në votim dhe me 4 vota për 10 vota kundër dhe 3 abstenime NUK U MIRATUA.

Fjalën e morri edhe Valmir Bacaj i cili propozoi që pikën 9 të hiqet nga rendi i ditës si arsye se ne si kuvend nuk kemi përvojë të mirë më komisionet hetimore dhe nuk kemi kapacitete njerëzore për verifikimet e të punësuarve në komunë pasi që asamblistët nuk kanë njohuri të madhe në këtë proces të regrutimit. Po ashtu formimi i një komisioni komunal për hetimin dhe sqarimin e dhënies së numrit të lejeve për operatorët gurëthyes, punë të cilën mund ta bëjë drejtoria e urbanizimit dhe mund të thirret në interpelancë prandaj kërkojmë që kjo pikë të largohet.

Në lidhje me thirrjen e interpelancës kryesuesi i kuvendit z. Gashi tha se ndoshta është më mirë që të thirren dy interpelanca për këto dy propozime për themelimin e komisioneve hetimore dhe nuk

ka nevojë të formohet këto komisione derisa këto çështje mund të debatohen dhe sqarohen në interpelanca. Kryesuesi tha se janë dy propozime : një që të hiqet pika e 9 dhe e dyta të thirret interpelancë në seancën e radhës me dy drejtoritë përkatëse.

z. Arben Limanaj tha se këto propozime që vijnë kështu në këtë formë në kuvend po na qesin ën lajthitje dhe po kemi dilema se si të marrim qëndrimin tonë si grup.

z. Valmir Bacaj tha se nuk është e thënë që të pajtohemi të gjitha grupet kuvendare me propozimet. Propozimi ynë ishte i qartë që të hiqet pika 9 e rendit të ditës dhe të thirret interpelancë me dy drejtoritë.

z. Esat Raci tha se te kjo pikë e rendit të ditës u krijua pak huti sepse Valmiri kërkoj që të hiqet pika 9 e rendit të ditës ndërsa kryesuesi tha që të hiqet dhe të thirret interpelancë ndërsa ata që e akne kërkuar këtë pikë të rendit të ditës akoma nuk e kanë arsyetuar këtë propozim. Për transparencë sipas z. Raci partia në pushtet nuk duhet të ketë frikë prandaj politikat e punësimit të bëhen transparente pasi që s` ka asgjë të keqe. Sa i përket LVV që ka kërkuar krijimin e komisioneve hetimore ata në nivel qendror jo më larg se sa dje i ikën krijimit të komisioneve hetimore për kontratat një burimore.

z. Zafer Gashi tha se deshifron që të përsëndes të gjithë besimtarët e krishterë pasi që të dielën janë pashkët. Prap procesverbali nuk është në rregull sepse nuk janë vendosur fjalët e mija qysh janë thënë. Ndërsa rreth kësaj , ne kemi ditur që të kërkojmë interpelanca edhe më përpara por ne kemi kërkuar formimin e komisioneve hetimore. Pastaj materialin tonë do ta ja bashkojmë materialit që do të grumbulloj komisioni hetimor. Z. Gashi në vazhdim shpjegoj në detaje për pikat që ata dëshirojnë të bëjnë hetim përmes një komisioni të formuar nga kuvendi, për punësimet dhe për fabrikën e çimentos, gurëthyesit etj. Ai kërkoj që të votohet të mbetet si pikë e rendit të ditës.

Propozimi i formuluar nga kryesuesi që të hiqet pika 9 nga rendi i ditës dhe të thirret interpelancë me dy drejtoritë u vu në votim dhe me 14 për, 2 kundër dhe 5 abstenime U MIRATUA.

Rendi i ditës në tërësi me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Mungojnë Blerta Gashi dhe Ilir Hoti.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit të seancës së kaluar.

Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga KPF-ë

Kryesuesi tha se janë dy kërkesa që janë adresuar. Një është rekomanduar tek drejtorja e arsimit dhe kërkesa e dytë tek drejtorja e shërbimeve publike. Përgjigjet do ti marrim tek pyetje e përgjigje.

Rekomandimet e KPF-së me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN

Pika 4 e Rendit të Ditës: shqyrtimi i propozim vendimit të drejtorisë së arsimit për ndërrimin e titullarit të pronës

z. Qemajl Sejdia, drejtor i DKA: Përshëndetje të gjithëve. Vendimi për ndërtimin e një çerdhe në pronën ku është shkolla fillore “Motrat Qiriazhi” në vitin 2023 jua kemi dërguar të gjitha dokumentacionin bashkë me kërkesën. Është konfirmuar që do të filloj ndërtimi në vitin 2024 dhe prap na ka ardhur një kërkesë që të ndërrohet titullari që parcela të mos jetë në emër të shkollës por në emër të komunës.

z. Arben Limanaj: Dëshiroi që të pyes se a është në përgjegjësinë tonë ndërrimi i titullarit. Ligjërisht a është në kompetencën tonë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nëse e ke mendimin për pronat shoqërore që i menaxhon AKP , nuk është në atë pronë. Është pronë shoqërore në emër të shkollës që duhet të ndërrohet titullari të kaloj në atë të komunës.

Me 25 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimi i drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për ndarjen e mjeteve për mbajtjen e festivalit folklorik “ I Këndojmë lirisë”

Kryesuesi tha se në buxhet është planifikuar dhe mjetet janë . Janë 25000 euro jo 20000 pasi që 5000 janë kërkuar që të jenë rezervë dhe nuk do të thotë që do të harxhohen. Të jenë rezervë që mos të ketë nevojë për procedura shtesë.

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijëve 2024-2026.

Pa debat, me 25 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për vënie në diskutim publik të rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale

Pas sqarimit të kryesuesit pa diskutim u vu në votim dhe me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 8 e Rendit të ditës: Informatë për menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Përshëndetje të gjithëve. Komuna e Klinës ka një kontratë tre vjeçare për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Drejtoria e jonë ka qenë në gjendje gatishmërie gjatë sezonit të dimrit. Me rastin e rënies së borës së parë Komuna ka reaguar dhe ka bërë pastrimin e të gjitha rrugëve nëpër fshatra ku ka pasur nevojë. Diku 150 km gjatësi janë pastruar brenda ditës dhe ajo ka qenë në kontrollë. Situata ka qenë e kënaqshme dhe rrugët kanë qenë të kaluara.

z. Esat Raci: Dëshiroj të pyes. Ngrica ka pasur edhe këtë vit. A keni mjete, buxhet që të rregullohen rrugët aty ku janë dëmtuar gjatë sezonit të dimrit. Kërkoj që ndërhyrje të tilla të behën menjëherë në pranverë.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Siç e kemi kontratën për mirëmbajtjen dimërore po ashtu e kemi kontratën edhe për sajimin e gropave që i rregullojmë gjithsesi. Edhe këtë vit kemi kontratën e tillë dhe sigurisht që do të ndërhyjmë ku ka nevojë.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Rishikimi i vendimit të marrë nga kuvendi për kompensimin e trupave dhe organeve që i formon Kuvendi. Kërkuar nga Ministria përkatëse.

Kryesuesi Gashi shpjegoi shkresën e ardhur nga ministria . Ai e lexoi shkresën që sipas ministrisë vendimi i kuvendit nuk është në harmoni me ligjin. Në vazhdim kryesuesi theksoi se kemi komitetin për komunitete ku 3 anëtarë të këtij komiteti paguhen dhe 4 anëtarë të tjerë nuk paguhen dhe kjo nuk është aspak barazi që nga ministria e kërkojnë. Vendimi i ynë i marrë në këtë kuvend tha kryesuesi është bazuar në të gjitha aktet nënligjore të prodhuar nga vet Ministria. Në vendimin tonë nuk e kemi nxjerrë bazuar në statusin e Komunës dhe as në rregulloren e Kuvendit por jemi bazuar në rregulloret, udhëzimet dhe dokumentet që i ka prodhuar Ministria dhe janë në fuqi.

Kryesuesi shpjegoi në vazhdim dokumentet se ku janë bazuar në kuvend kur e kanë marrë këtë vendim. Por, kryesuesi tha se jemi para tre alternativave: Jemi brenda afatit për rishqyrtim dhe si kuvend ne e plotësojmë kriterin derisa e rishqyrtojmë dhe mbesim në përkrahje të këtij vendimi dhe këtë çështje e zgjedh gjykata në vazhdim, e dyta alternativë është që të anulohet ky vendim dhe e treta alternativë është që Komuna e Klinës ta padisë ministrinë për këtë shkresë. Individualisht çdonjëri nga këto trupa që i kemi themeluar në kuvend mund të na padisin për mos pagesë ose mundësia tjetër është që është edhe logjika e ministrisë që të gjithë trupat e themeluar të anulohen dhe të mbetet vetëm dy komitetet konsultative.

z. Esat Raci: Unë propozoj që të qëndrojmë pranë vendimit që kemi marrë. Po e rishqyrtojmë sipas kërkesës dhe po mbesim pranë vendimit tonë. Nëse do ministria le ta dërgoj në gjykatë vendimin e kuvendit.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Së pari ju uroj të gjithë shqiptarët për dy festa që kemi përpara Pashkët dhe Bajramin. Tani, derisa vet ky kuvend i ka themeluar këto komitete e trupa, qëndroj pran faktit se këto trupa duhet paguar për aktivitetin që bëjnë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Duhet ta kemi parasysh një fakt se ky është një vendim që nuk e ka ligjshmërinë dhe do të jetë problem që të ekzekutohet. Pajtohem plotësisht me diskutimet edhe të kryesuesit edhe të anëtarëve të kuvendit por mendoj që është më mirë të anulohet dhe të kemi një përpjekje të re pasi që të jemi konsultuar pak më shumë duke gjetur mundësi më të mira. Nëse qëndrojmë pranë këtij vendimi besoni se do të shkoj kohë e gjatë deri të merr epilog.

z. Fadil Gashi, kryesues: Jemi të vetëdijshëm që epilogu i gjykatës për këtë vendim do të merr kohë të gjatë dhe deri në atë epilog nuk ka dilema që s`mund të bëjë pagesë komuna. Në lidhje me koordinim ose mos koordinim unë e kam shkresën e datës 20 qershor 2023 që ju kam drejtuar ministrive në emër të kolegjiut për këtë çështje dhe çështje të tjera.

Kryesuesi zërthej shkresën drejtuar ministrive në emër të Kolegjiut pasi që është edhe kryetar i kolegjiut dhe tha se përpjekja me nivelin qendror ka qenë konstante dhe koherente për gjetjen e një zgjidhje.

z. Valmir Bacaj: Ndoshta më e rrugës do të ishte që zyra ligjore të na përgatisë një shkresë dhe të dërgohet në gjykatë dhe pastaj një vendim i gjykatës do ta sqaronte këtë çështje.

z. Kolë Prenaj: Përshëndetje. Unë kam edhe një kërkesë që nëse llogaritet marrëdhënie e punës paga e asamblistit, edhe përvoja e punës mundësisht që të i bashkëngjitet kësaj kërkesë.

z. Binak Sylaj, drejtor i administratës: Përshëndetje. Unë sa jam në dijeni, çështja e përvojës së punës është e rregulluar. Është diskutabile për ata që kanë dalë në pension të cilëve nuk ju ndalen kontributet dhe sistemi nuk i pranon por mbetet të shikohet në instanca më të larta.

Pas diskutimit të më tejshëm për këtë çështje, se cilin variant të zgjedhin dhe që do të ishte më i pranueshëm u propozua që Vendimi të anulohet dhe ditëve në vazhdim të shihet dhe bëhet përpjekje për një vendim tjetër pasi të jenë konsultuar me të gjithë faktorët relevant me qëllim që të merret konfirmimi ligjor paraprakisht ashtu siç propozoj kryetari i Komunës, z. Elezaj.

Ky variant u vendos në votim dhe me 20 vota për 2 abstenime asnjë kundër u ANULUA Vendimi i seancës së kaluar.

Drejtori Binak Sylaj para se të kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës kërkoj nga anëtarët e komisionit për zgjedhjen e këshillave në bashkësi për një takim të shkurtër për disa sqarime në lidhje me koordinimet e punës.

Pika 10 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje

z. Fadil Gashi, kryesues: Unë dua të ngrit një shqetësim që ka të bëjë me varrezat e qytetit në Zajm. Janë 27 hektar që i kemi dhënë për 5 hektar të varrezave. Nuk ka asnjë kriter që përdoret as në ceremoni varrimi as në varrime as në mirëmbajtje. Kemi një rregullore që shumë mirë i përcakton përgjegjësitë dhe obligimet. Mes tjerash në këtë rregullore neni 14, të merret leje nga organi kompetent ose ndërmarrja që e autorizon Komuna. Aty kanë nisë me zënë tokë me i vendos rrethojat me rezervuar vendin për varrime të familjareve. Duhet gjetur mënyra se si ti qaset mirëmbajtjes së varrezave të cilat nuk kanë staza nuk ka fare mirëmbajtje. Askush nuk lirohet nga përgjegjësia. Neni 16 thotë se në mesin e atyre që ndalohet është edhe prishja e rendit ën varreza. Unë kam bërë fotografi që shihet se varrimet janë krejtësisht pa radhë. Për varre familjare janë procedura që parashihen edhe në rregullore . Është shqetësim sepse në fund të fundit janë pasqyrë e jona, kulturë e jona dhe dikush duhet të merret me këtë çështje.

z. Tunë Dedaj: Pajtohem shumë me atë që thatë ju por kam një kërkesë që në varrezat e qytetit të ndahet edhe një hektar për varret të të krishterëve.

Kryesuesi saktësoj që kur është bërë rregullorja e edhe kur është ndarë toka për varreza është ndarë për të dy besimet fetare.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Është e ndarë me marrëveshje gojore për besimtarë të krishterë. Pajtohem me atë që e tha kryesuesi por ne jua kemi lënë në dorë bashkësisë fetare. Janë ndërtuar edhe shtigjet e ecjes konform rregullave fetare por gjithsesi ne përmes drejtorisë së shërbimeve publike dhe inspektorati do të bëjmë takime dhe do të fillojmë që të caktojmë rregullat sipas rregullores.

z. Arben Limanaj: Pyetjen e parë e kam për drejtorinë e urbanizimit, një pyetje nga qytetari i Dobërdolit për varrezat e Dobërdolit, varrezat e këtij fshati, se a është iniciuar si procedurë për këtë

vit. Pyetjen e dytë e kam për borxhet që ka komuna ndaj mësimdhënësve për shujta, transport, kualifikim etj. Një vendim gjykate është marrë në favor të mësimdhënësve por komuna e ka apeluar këtë vendim. Thjesht dëshiroi të kem një përgjigje nga ekzekutivi.

z. Qemajl Sejdia, drejtor i DKA: Komuna e Klinës për dallim nga komunat e tjera qëndron shumë më mirë sa i përket zbatimit të kontratës kolektive. Jemi një ndër komunat që kemi paguar më së shumti. Sa e diji unë, kemi edhe 84 mijë euro borxh. Vitin e kaluar ishte planifikuar që të paguhen në mënyrë lineare dhe i kemi dërguar për pagesë por është qeveria që i ka stopuar. Ministria e arsimit dhe ajo e financave i kanë bllokuar. Përndryshe ne kemi paguar aq sa kemi pas mundësi që mësimdhënësit mos të shkojnë nëpër gjykata. Të gjitha lëndët që janë pa paguar janë në proces gjyqësor.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Përshëndetje. Sa i përket varrezave në fshatin Dobërdol, kjo është çështje e drejtorisë së Shërbimeve publike.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Projekti i rrethojave të varrezave është në procedurë të prokurimit dhe këtë vit do të përfundoj.

z. Zafer Gashi: Kam një pyetje për kryetarin. Ka qenë një thirrje publike prej ministrisë së planifikimit hapësinor për ndarjen e lokacioneve për ndërtimin e banesave për çiftet. A keni arritë që të kompletoni dokumentacionin e nevojshëm dhe a keni aplikuar për këtë projekt të qëlluar. Një qytetar i Kërrnicës më ka shkruar që të pyes kryetarin për gjendjen e ujit të pijshëm në Kërrnicë, pasi që kanalizimet po përzihen me ujët e pijshëm dhe kanë nisur të përhapen sëmundje të ndryshme.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ne kemi propozuar një tokë në drejtim të rrugës të fabrika e këpucëve. Por kemi një problem sepse nuk është zonë që i përshtatet ndërtimit kështu që ka mbetur që të rregullohet përmes PZHK. Unë kam kërkuar që të dërgohet ashtu siç është dhe a do të merret parasysh do të shohim, është dërguar me vonesë sepse kanë pasur probleme me destinimin e tokës dhe teren tjetër nuk kemi gjetur. Lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Kërrnicë dhe përzjerjen me ujëra të zeza është mirë që të i drejtohet tek drejtoria e urbanizmit. Nuk po e diji si ka mundësi që të përzihet uji i pijshëm me ujërat e zeza përveç nëse uji i pijshëm merret nga puset. "Hidrodrini" i bënë analizat dhe monitoron kualitetin e ujit gjithsesi. Këtë vit në Kërrnicë është planifikuar që të ndërtohet kanalizimi i ujerave të zeza dhe janë 80 mijë euro të ndara dhe i cili kanalizim do të lidhet me kanalizimin e fshatit Shtupel. Mund të mos përfundoj komplet këtë vit por është planifikuar edhe vitin tjetër që të përfundoj dhe edhe nëpër lagje të Kërrnicës të shtrihet kanalizimi.

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje. Kam tre pyetje. 1. për drejtorin e shëndetësisë. Kam qenë me 16 mars rreth orës 16 dhe kishin qenë tre pacient duke pritur për lirim të shtratit për marrjen e infuzioneve por kur ka ardhur pacienti i katërt, një teknik e ka marrë dhe e ka futur nga emergjenca direkt në shtrat pa pritur radhën hiç. 2. Për drejtorin e administratës: Makinat zyrtare pas orarit të punës a parkohen këtu te gjykata apo ka drejtor që e shfrytëzon pas orarit të punës. 3. Për drejtorin e Bujqësisë: Një fermer nga fshati Gjurgjevik, Dinë Banushaj, ka bërë kërkesë për inspektim sepse po i ngordhin delet, rreth 50 dele deri tash por askush nuk e ka vizatur nga Komuna. Dhe pyetja e fundit për drejtorin e urbanizmit: Pranimin teknik të rrugëve që e keni bërë para vitit të ri, d.m.th. në 2023, e që ato rrugë akoma nuk kanë përfunduar, çka do të bëhet me to.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Pacientët nëse janë duke pritur në radhë , duhet të presin, tekniku nuk ka të drejt të merr asnjë pa radhë .

z. Binak Sylaj, drejtor i administratës: Të gjitha veturat që shfrytëzohen nga zyrtarët publik kthehen në parkim pas orarit të punës. Janë disa drejtori që i kanë disa detyra të veçanta dhe që i shfrytëzojnë makinat edhe pas orarit të punës por në shërbim të qytetarëve e jo në shërbim të vetvetes.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Po ka qenë fermeri tek unë, e diji rastin. Unë e kam udhëzuar që të shkoj në inspektorat të bëjë një procesverbal të konstatoj gjendjen me një veterinar dhe në AVUK. Nuk kemi asnjë kompetencë ne si drejtori.

z. Faruk Smajli, drejtor i inspektoratit: Kjo kërkesë ka ardhur edhe në inspektorat dhe ne kemi bërë procesin të cilin e kemi dërguar në AVUK. Ata i kanë marrë dy mostra dhe janë duke bërë analizat.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: I nderuar Kushtrim nuk ndodhë me u bërë pranimi teknik pa u krye puna. Nuk e diji cila rrugë, cili projekt. Është mirë që të specifikohet ku është ai rast.

z. Kushtrim Haliti: Ka të bëjë me rrugën “Afrim Haliti”. Të kam pyet edhe këtu në kuvend dhe keni deklaruar që po është bërë pranimi teknik. Pas seance mund shkojmë në vend dhe e shef që nuk ka përfunduar ajo rrugë.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Kanë qenë dy projekte për atë rrugë. Një projekt bazë dhe një tjetër aneks memorandum me Komunën e Skenderajt. Ajo ka përfunduar si rrugë por mund të ketë pasur dëmtime gjatë sezonit të dimrit. Operatori e ka kontratën dhe para masat, çdo gjë që ka në para masë i ka vendosur.

Znj. Leonora Jaha- Dakaj: Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e financave lidhur me tatimin e tokave bujqësore. A mund të na jepni një informatë se sa është tatimi për një ari dhe kur është afati i pagesave. A do të ketë masa ndëshkuese nëse nuk kryhen pagesat me kohë?

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Përshëndetje. Tani ka hyrë edhe tatimi në tokë dhe nuk është tatimi i njëjtë për të gjitha tokat. Ajo varet nga kategoria e tokës. Afati për pagesën e parë është 30 prilli ndërsa nga 1 maji fillon me u apliku kamata.

z. Fadil Gashi, kryesues: A mund at dijë se kujt i faturohet kjo sepse nëse i faturohet babagjyshit tim është e kotë.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Tatimi faturohet në emër të pronarit ose ish pronarit.

Pasi që nuk kishte pyetje të tjera në këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi duke ju uruar festen e pashkëve i falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë dhe e shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesues:

Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

RAPORT I MENAXHIMIT FINANCIAR I KOMUNËS SË KLINËS PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2024

RAPORTI ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI MENAXHIMIN E FINANCAVE
PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
1.1. Granti Qeveritar.....	3
1.2. Granti i të hyrave vetanake	3
1.3. Të hyrat vetanake të bartura.....	3
1.4. Performanca e shpenzimeve.....	4
2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2024 duke i përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit	5
3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2024 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak	6
3.1. Realizimi i të hyrave për periudhën janar-mars 2024 sipas muajve	7
4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2024 dhe krahasimi me vitin paraprak.....	9
4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-mars 2024 sipas kategorive ekonomike.....	10
5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2024 - raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK	12

1. Hyrje

Raporti për periudhën Janar-Mars 2024 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave .

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën Janar – Mars 2024 është punuar për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën Janar – Mars 2024 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Buxheti sipas SIMFK për vitin 2024 duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe te jashtme ishte 14,718,391.28 €, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 8.79% se buxheti i vitit 2023.

Gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 37.72% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e shpenzimeve kapitale dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve.

1.1 Granti Qeveritar

Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 89.77% në periudhën janar-mars 2024 (shuma 13,212,457.00 €). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 13.14% më i lart.

1.2 Granti I të hyrave vetanake

Të hyrat vetanake të komunës gjatë tremujorit të parë, janë arkëtuar në vlerën e përgjithshme vjetore 23.83 %, ndërsa kanë shënuar rënie prej 3.22 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij tremujori kanë arritur shumën prej 331,202.72 € (23.83 %) e buxhetit total në këtë periudhë, të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rënie prej 3.22% që korrespondon me 11,016.17 € më pak në krahasuar me tremujorin e vitit paraprak.

1.3 Të hyrat vetanake të bartura

Buxheti nga THV të bartura të vitit 2023 gjatë periudhës Janar-Mars 2024 nuk është bartur në SIMFK

Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet e brendshme të bartura, participimet e qytetarëve dhe grante tjera siq janë :

- ❖ **Granti i donatorëve të brendshëm - Participimi i qytetarëve** në shumën prej 48,757.94 €, në raport me vitin paraprak buxheti nga ky grant është **55.62 %** (shuma 17,425.82€) më i lartë se në vitin paraprak, mjete këto të bartura nga viti 2023.
- ❖ **Grante tjera të jashtme - Donacion i jashtëm** në shumën prej 18,341.33 €, mjete këto të bartura nga viti 2023.

1.4 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore në periudhën Janar-Mars 2024 në shumën prej 3,082,783.27 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2023 në shumën prej 2,238,489.97 € janë më të larta për 37.72 % . Ndikim në rritjen e shpenzimeve ka pasur kategoria e shpenzimeve kapitale (rritje në kryerjen e punëve) dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve (pagesat e obligimeve lindje dhe varrime dhe subvencionimi i bujqëve).

Buxheti i shpenzuar në periudhën Janar-Mars 2024 në shumën prej 3,082,783.27 € është 20.95 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me shumën e përgjithshme të buxhetuar për vitin 2024. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 3,006,181.83€ (22.76 % në raport me buxhetin nga granti), nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 64,614.93 € (4.50% në raport me buxhetin nga granti), nga donacionet e brendshme janë shpenzuar 11,986.50 € (24.58% në raport me buxhetin nga granti).


Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 3,082,783.27 € nga granti qeveritar janë shpenzuar 97.52% , nga të hyrat vetanake 2.10% dhe nga donacionet e brendshme 0.39 % . Krahasuar me vitin 2023 , shpenzimet për këtë periudhë janë më të larta për 37.72 % .

- ❖ **Shpenzimet për paga dhe medijtje** gjatë këtij tremujori, shënuan shpenzimin prej 1,999,702.68€, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 25.20 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 15.23%, apo rreth 264,755.46 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2023. Ndikim në këtë rritje të shpenzimit ka pasur ndryshimi i koficientëve të pagave.
- ❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** kanë shënuar një rritje prej 20.21% krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur në 426,200.42 €, kjo shumë korrespondon me 24.92% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 20.21%, apo rreth 71,639.59 € më shumë krahasuar me shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve në periudhën e njëjtë të vitit 2023.
- ❖ **Shpenzimet në komunal**, kanë shënuar rritje prej 13.59% krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur 90,901.07 €, kjo shumë korrespondon me 36.36% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e komunaleve gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 13.59 % , apo rreth 10,876.46 € më shumë krahasuar me shpenzimet e komunaleve në periudhën e njëjtë të vitit 2023.
- ❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan shumën prej 110,964.43 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 17.51% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Te subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rritje prej 712.93%, apo rreth 97,314.43 € më shumë krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjtë të vitit 2023.
- ❖ **Shpenzimet kapitale**. Shpenzimet kapitale arritën shumën prej 455,014.67 €, që është 10.87% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet kapitale gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 729.20 % , apo rreth 400,140.50 € më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2024 duke përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2024	% në total	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023	Ndryshimi 2024/2023 në %
Granti qeveritar	13,212,457.00	89.77	11,677,821.00	13.14
Të hyrat vetanake 2024	1,436,260.00	9.76	1,373,774.00	4.55
Të hyrat e bartura	-	-	-	-
31_Granti I donatorëve të brendshëm	48,757.99	0.33	31,332.12	55.62
32_Granti I donatorëve të jashtme	18,341.33	0.12	18,341.33	
46_ Save The Children	-	-	1,510.50	(100.00)
61_Granti I jashtëm (Performancës)	2,575.01	0.02	426,739.48	
TOTALI	14,718,391.33	100.00	13,529,518.43	8.79


Tabela 1. Buxheti Janar-Mars 2024 sipas burimit të financimit



Grafiku 1. Buxheti në SIMFK sipas burimit

2. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2024 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Nr.	Kodi ekonomik	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Tremujori	%	Tremujori	%	Krahasimi në %	Ndryshimi
			2023	Ne total	2024	Ne total	2024/2023	ne €
1	40110	TATIMI NË PRONË	100,430.34	29.35	97,545.74	29.45	-2.87	-2,884.60
2	50001	TAKSË REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	19,445.00	5.68	20,597.42	6.22	5.93	1,152.42
3	50009	TAKSË PËR LEJE NDËRTIMI	113,132.55	33.06	98,973.51	29.88	-12.52	-14,159.04
4	50013	ÇERTIFIKATAT E LINDJES	167.00	0.05	116.00	0.04	-30.54	-51.00
5	50014	ÇERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	-	0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
6	50015	ÇERTIFIKATAT E VDEKJES	168.00	0.05	382.00	0.12	127.38	214.00
7	50016	ÇERTIFIKATA TJERA	9,371.00	2.74	8,024.00	2.42	-14.37	-1,347.00
8	50017	TAKSË VERIF. DOK.TË NDRYSHME	836.00	0.24	1,760.00	0.53	110.53	924.00
9	50019	TAKSA ADMINISTRATIVE	822.60	0.24	1,113.10	0.34	35.31	290.50
10	50024	ÇERTIFIKATAT MJEKSORE		0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
11	50026	TAKSË PË LEGALIZIM	2,922.08	0.85	2,964.37	0.90	1.45	42.29
12	50029	TAKSË PËR USHTRIM TE VEPRIMTARISË	18,440.00	5.39	20,682.00	6.24	12.16	2,242.00
13	50032	TAKSË PËR FLETË POSEDUESE	5,082.00	1.49	4,270.00	1.29	-15.98	-812.00
14	50103	LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJE	345.00	0.10	500.00	0.15	44.93	155.00
15	50104	GJOBAT NGA INSPEKTORIATI	8,092.23	2.36	4,480.00	1.35	-44.64	-3,612.23
16	50205	LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	1,626.50	0.48	1,286.78	0.39	-20.89	-339.72
17	50401	SHITJA E SHERBIMEVE		0.00		0.00	#DIV/0!	0.00
18	50403	TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE		0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
19	50405	SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	2,793.03	0.82	2,182.68	0.66	-21.85	-610.35
20	50406	PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR		0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
21	50407	QIRAJA VENDOSJA OBJEKT TREGTAR	681.00	0.20	1,639.00	0.49	140.68	958.00
22	50408	QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	8,118.06	2.37	4,162.99	1.26	-48.72	-3,955.07
23	50409	PARTICIPIM - SHENDETSIA	9,779.50	2.86	8,282.50	2.50	-15.31	-1,497.00
24	50409	PARTICIPIM - QERDHJA	7,760.00	2.27	7,343.30	2.22	-5.37	-416.70
25	50409	PARTICIPIM - ARSIMI I MESEM	18,280.00	5.34	28,885.00	8.72	58.01	10,605.00
26	50409	PARTICIPIM NGA GJEODEZIA	39.00	0.01	-	0.00	-100.00	-39.00
27	50504	TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	13,888.00	4.06	16,012.33	4.83	15.30	2,124.33
		GJITHESEJT:	342,218.89		331,202.72		-3.22	-11,016.17




Grafiku 2. Të hyrat vetanake sipas viteve

Tabela 3.1. Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën janar-mars 2024 sipas muajve

Nr.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Të hyrat janar 2024	Të hyrat shkurt 2024	Të hyrat mars 2024	Totali i të hyrave janar-mars 2024
1	40110	Tatimi ne prone	31.204.12	30.362.00	35.979.62	97545.74
2	50001	Taksa rrugore	7.281.92	6.005.00	7.310.50	20597.42
3	50009	Urbanizem	1.968.99	2.653.45	94.351.07	98973.51
4	50013	Çertifikatat e lindjes	68.00	16.00	32.00	116.00
5	50014	Çert. E kurorozimit	-	-	-	0.00
6	50015	Çertifikatat e vdekjes	131.00	120.00	131.00	382.00
7	50016	Çertifikatat tjera	3.313.00	2.247.00	2.464.00	8024.00
8	50017	Te hyrat tjera	800.00	640.00	320.00	1760.00
9	50019	Taksa administrative	695.70	288.50	128.90	1113.10
10	50024	Çertifikatat mjeksore	68.00	54.00	72.00	194.00
11	50026	Takë per legalizim	1.523.87	432.54	1.007.96	2964.37
12	50029	T.per usht.veprimtar.	5.742.00	2.790.00	12.150.00	20682.00
13	50032	Taksë per flet posed.	1.188.00	945.00	2.137.00	4270.00
14	50103	Marimanga	500.00		-	500.00

				-		
15	50104	Denimet mandatore	230.00	300.00	3.950.00	4480.00
16	50205	Komisioni inspektues	390.28	267.00	629.50	1286.78
17	50401	Shitja e sherbimeve	-	-	-	0.00
18	50403	Shitja e pasurise	-	-	-	0.00
19	50405	Shfryt.pron.publike	100.00	1.872.68	210.00	2182.68
20	50406	Qer. per treg te hapur	-	-	-	0.00
21	50407	Qeraja e lokaleve	1.275.00	182.00	182.00	1639.00
22	50408	Qeraja per banim	2.986.74	816.25	360.00	4162.99
23	50409	Participim - shendetsi	3.242.50	2.301.00	2.545.00	8088.50
24	50409	Participim - qerdhja	2.354.00	2.415.30	2.574.00	7343.30
25	50409	Participim - shp. F.A.	7.385.00	18.740.00	2.760.00	28885.00
26	50409	Participim nga gjeod.	-	-	-	0.00
27	50409	Donacion I jashtem		-	-	
28	56000	Participim I qytetareve		-	-	
29	50504	Kadaster & gjeodezi	5.233.00	4.643.33	6.136.00	16012.33
TOTALI			77.681.12	78.091.05	175.430.55	331.202.72




Grafiku 3. Të hyrat sipas muajve

4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2024 dhe krahasimi me vitin paraprak

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2024	% në total	Buxheti i shpenzuar Janar-Mars 2024	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenzimeve Janar-Mars 2024	Buxheti i shpenzuar Janar-Mars 2023	Krahasimi i shpenz. 2024 me 2023 në %
Granti qeveritar	13,212,457.00	89.77	3,006,181.83	22.76	97.52	2,237,482.97	34.37
Të hyrat vetanake 2024	1,436,260.00	9.76	64,614.93	4.50	2.10	0	#DIV/0!
Të hyrat e bartura	-	-	-			0	
31_Granti I donatorëve të brendshëm	48,757.99	0.33	11986.5	24.58	0.39		#DIV/0!
32_Granti I donatorëve të jashtme	18,341.33	0.12		0.00			
46_ Save The Children	-	-		#DIV/0!	0.00	1,007.00	-100.00
61_ Granti I jashtëm (Performancës)	2,575.01	0.02		0.00			
TOTALI	14,718,391.33	100.00	3,082,783.27		20.95	2,238,489.97	37.72

Tabela 4. Shpenzimet buxhetore Janar-Mars 2024 krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar




Grafiku 4. Shpenzimet buxhetore Janar-Mars 2024 krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar

4.1 Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-mars 2024 sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Buxheti në SIMFK 2024	Shpenzimet janar-mars 2024	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenz. janar-mars 2024	Shpenzimet janar-mars 2023	Krahasimi 2024 me 2023 në %
						në %
Paga dhe mëditje	7,936,857	1,999,702.68	25.20	64.87	1,735,380.33	15.23
Mallra dhe shërbime	1,710,000	426,200.42	24.92	13.82	354,560.83	20.21
Shërbime komunale	250,000	90,901.07	36.36	2.95	80,024.61	13.59
Subvencione dhe transf.	633,861	110,964.43	17.51	3.60	13,650.00	712.93
Kapitalet	4,187,674	455,014.67	10.87	14.76	54,874.20	729.20
TOTALI	14,718,391.33	3,082,783.27	20.95	100	2,238,489.97	37.72

Tabela 5. Shpenzimet buxhetore janar-mars 2024 sipas kategorive ekonomike



Grafiku 4.1. Shpenzimet buxhetore në periudhën Janar – Mars 2024 sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – mars 2024 në shumën prej 3,082,783.27 €:

- Për paga dhe medijtje janë shpenzuar 1,999,702.68€ (25.20 % në raport me buxhetin e alokuar për paga)
- Për mallra e shërbime janë shpenzuar 426,200.42 € (24.92 % në raport me buxhetin e alokuar për mallra e shërbime)
- Për shërbime komunale janë shpenzuar 90,901.07€ (36.36% në raport me buxhetin e alokuar për shërbime komunale)
- Për subvencione janë shpenzuar 110,964.43 € (17.51% në raport me buxhetin e alokuar për subvencione) dhe
- Për shpenzime kapitale 455,014.67 € (10.87% në raport me buxhetin e alokuar për shpenzime kapitale).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 3,082,783.27 €, për paga e medijtje janë 64.87 % e shpenzimeve, për mallra dhe shërbime 13.82 % e shpenzimeve, për shërbime komunale 2.95 % e shpenzimeve, për subvencione 3.60 % e shpenzimeve dhe për kapitale 14.76 % e shpenzimeve.

Shpenzimet në periudhën Janar-Mars 2024 në shumën prej 3,082,783.27 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2023 në shumën prej 2,238,489.97 € janë më të larta për 37.72 % . Shpenzimet për paga dhe medijtje krahasuar me vitin paraprak janë më të larta për 15.23%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të larta për 20.21%, shpenzimet për shërbime komunale janë më të larta për 13.59 %, shpenzimet për subvencione janë më të larta për 712.93 % dhe shpenzimet kapitale janë më të larta për 729.20 %.

5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2024, raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK

Nr.	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Shpenzimet Janar-Mars /2024	Shpenzimet janar- mars /2023	Ndryshimi
1	11111	PAGAT NETO PERMES LISTAVE	1.523.665.75	1.471.004.48	52.661.27
2	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	116.428.47	-	116.428.47
3	11131	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	94.985.24	-	94.985.24
4	11151	SINDIKATAT	3.763.35	2.793.92	969.43
5	11152	ODAT PROFESIONALE	3.451.44	2.727.68	723.76
6	11211	PËRVOJA E PUNËS	82.807.31	-	82.807.31
7	11311	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	94.985.24	-	94.985.24
8	11400	PUNT. ME KONT.(JO NË LISTË TË PAGAVE)	-	864.38	(864.38)
9	11411	SHTESA E VEÇANTË PËR TË ZGJEDHURIT	12.348.51		12.348.51
10	11416	SHTESA PËR VËLLIMIN E PUNËS	276.38		276.38
11	11431	KUJDESTARIA, PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS	65.396.83		65.396.83
12	11500	TATIMI NE TARDHURA PERSONALE	-	93.325.03	(93.325.03)
13	11600	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORI	-	82.332.42	(82.332.42)
14	11611	SHTESAT TRANZITORE	1.594.16	-	1.594.16
15	11700	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSI	-	82.332.42	(82.332.42)
16	11900	PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORE	-	-	-
	TOTALI: 11	RROGAT DHE PAGAT	1.999.702.68	1.735.380.33	264.322.35

15	13130	SHPEN.UDHTIMIT BRENDA	-	7.179.41	(7.179.41)
16	13310	SHPENZ. PËR INTERNET	682.78	-	682.78
17	13320	SHPENZ.E TELEFONIT-VALA 900	1.937.22	2.713.83	(776.61)
18	13330	SHPENZIMET POSTARE	321.70	166.40	155.30
19	13430	SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETSORE	34.777.90	47.746.60	(12.968.70)
20	13445	SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL	15.819.84	-	15.819.84
21	13450	SHËRBIME SHTYPJE - JO MARKETING	1.030.67	3.987.61	(2.956.94)
22	13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA	34.149.29	52.467.20	(18.317.91)
23	13470	SHERBIME TEKNIKE	12.994.96	800.00	12.194.96
24	13475	SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE	9.729.00	-	9.729.00
25	13480	SHPENZIMET PER ANETARESIM	5.774.40	5.872.00	(97.60)
26	13490	SHERBIMET E VARRIMIT	-	185.00	(185.00)
27	13501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	6.716.00	-	6.716.00
28	13503	KOMPJUTERËT	5.590.00	-	5.590.00
29	13509	PAISJE TJERA<1000 EURO	360.00	2.404.00	(2.044.00)
30	13610	FURNIZIME PER ZYRE	6.496.21	4.689.77	1.806.44
31	13611	FURNIZIMI ME DOKUMENTE BLLANKO	2.000.00	-	2.000.00
32	13620	FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA)	5.323.93	4.197.60	1.126.33
33	13630	FURNIZIME MJEKSORE			

			34.337.59	16.126.87	18.210.72
34	13640	FURNIZIM PASTRIMI			
			1.706.80	2.100.01	(393.21)
35	13650	FURNIZIME ME VESHMBATHJE			
			-	901.00	(901.00)
36	13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE			
			3.994.09	-	3.994.09
37	13760	DRU			
			32.654.00	20.888.00	11.766.00
38	13770	DERIVATE PER GJENERATOR			
			-	523.63	(523.63)
39	13780	KARBURANTE PER VETURA			
			18.919.31	13.106.60	5.812.71
40	13820	AVANC PËR UDHËTIME ZYRTARE			
			-	208.00	(208.00)
41	13950	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE			
			810.00	340.00	470.00
42	13951	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE			
			1.998.16	913.46	1.084.70
43	13953	SIGURIMI I NDERTESAVE TJERA			
			-	1.260.24	(1.260.24)
44	13954	KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETEVE			
			90.00	-	90.00
45	14010	MIRM.RIPARIMI I AUTOMJETEVE			
			14.168.90	4.135.61	10.033.29
46	14020	MIRMBAJTJA E NDERTESAVE			
			-	1.480.32	(1.480.32)
47	14022	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE			
			11.474.52	-	11.474.52
48	14023	MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE			
			39.141.65	16.401.22	22.740.43
49	14024	MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE			
			13.535.90	-	13.535.90
50	14032	MIRMBAJTJA ERRUGEVE LOKALE			
			94.855.40	122.990.30	(28.134.90)
51	14040	MIRMB.TEKNO.INFORMATIVE			
			820.00	-	820.00

52	14050	MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE			
			9.155.60	18.314.30	(9.158.70)
53	14060	MIRËMBAJTJA RUTINOREMIRËMBAJTJA RUTINORE			
			2.288.00		2.288.00
54	14120	QIRAJA PER TOKE			
			-	482.25	(482.25)
55	14210	REKLAMAT DHE KONKURSET			
			850.00	500.00	350.00
56	14230	SHPENZIMET PËR INFORMIM PUBLIK			
			1.247.50	850.00	397.50
57	14310	KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT			
			449.10	629.60	(180.50)
58	14410	SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE			
	TOTALI: 13	MALLRA DHE SHERBIME			
			426.200.42	354.560.83	71.639.59
59					
	13210	RRYMA	73.072.09	47.379.92	25.692.17
60					
	13220	UJI	3.706.41	1.084.63	2.621.78
61					
	13230	MBETURINAT	12.827.47	30.692.77	(17.865.30)
62					
	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	1.295.10	867.29	427.81
	TOTALI: 14	SHPENZIMET KOMUNALE			
			90.901.07	80.024.61	10.876.46
63	21200	SUB.PER ENTITETET JOPUBLIKE			
			-	13.650.00	(13.650.00)
64	22202	TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË			
			110.964.43	-	110.964.43
	TOTALI: 20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET			
			110.964.43	13.650.00	97.314.43
65	31120	NDËRTHESAT ADMINISTRATËS AFARISTE			
			-	-	-
66	31121	OBJEKTET ARSIMORE			
			2.995.00	-	2.995.00
67	31124	OBJEKTET SPORTIVE			

					-
68	31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE			
			253.523.12	45.374.20	208.148.92
69	31240	TROTUARET			
			48.496.55		48.496.55
70	31250	KANALIZIMI			
				-	-
71	31260	RRJETET E UJESJELLESIT			
			50.000.00	9.500.00	40.500.00
72	31690	PAJISJE TJERA			
					-
73	32000	INVESTIMET NE VIJIM			
			-	-	-
74	32110	SHTRETËRIT E LUMENJVE			
			100.000.00	-	100.000.00
	TOTALI: 30	PASURIT JO FINANCIARE			
			455.014.67	54.874.20	400.140.47
TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30					
			3.082.783.27	2.238.489.97	844.293.30

Klinë, 3.04.2024

Zyrtarja Kryesore Financiare

Melihate Behramaj
